

UDHËZIM

Nr. 6/1, datë 15.5.2019 PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 6, DATË 25.2.2019 “PËR FUNKSIONET, AUTORITETIN DHE PËRGJEGJËSITË E AVOKATIT TË TATIMPAGUESVE, PROCEDURAT QË DO TË ZBATOHEN PREJ TIJ NË MBROJTJE TË INTERESAVE TË TATIMPAGUESVE, SI DHE PROCEDURAT QË DUHET TË NDIQEN NGA TATIMPAGUESIT, PËR TË PËRFITUAR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË TYRE NGA AVOKATI I TATIMPAGUESVE”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të nenit 105/2, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 648, datë 28.7.2010 “Për Avokatin e Tatimpaguesve”, i ndryshuar, Ministri i Financave dhe Ekonomisë

UDHËZON:

1. Në pikën 2 “Organizimi i Avokatit të Tatimpaguesit”, pika 2.4, germa “b”, ndryshohet me këtë përmbajtje:

“b) të ketë eksperiencë pune në administratën tatimore dhe/ose në pozicione pune që mbulojnë funksione politikëbërëse, rregullatore apo çështje juridike të administratës tatimore në ministrinë përgjegjëse për financat.”

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I FINANCAVE DHE
EKONOMISË
Anila Denaj**

Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 72, datë 20.05.2019